



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**

**nr.320, datë 24/06/2014**

**“Për**

**shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjeve “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 315, datë 13.05.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve””**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO(LATI)	Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar
Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
Iva	ZAJMI	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.06.2014 shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjeve “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA për revokimin e Vendimit nr. 315, datë 13.05.2014 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve”.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, germa d, dhe neni 46 .

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të kërkesës së ndërmarrjeve “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA për revokimin e Vendimit nr. 315, datë 13.05.2014 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve” dhe relacionit të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës për këtë kërkesë

**VËREN SE:**

1. Më datë 09.06.2014 pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar një kërkesë nga ndërmarrjet “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA, me atë të së cilës këto ndërmarrje kërkojnë revokimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 315, datë 13.05.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve”.
2. Revokimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, mund të bëhet vetëm nëse plotësohet njëri nga kriteret e parashikuara në Nenin 46 të Ligjit për mbrojtjen e

konkurrencës. Sipas këtij Neni, Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:

- a) njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar;
  - b) palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
  - c) vendimi është bazuar në të dhënat jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.
3. Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjeve “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA dhe i argumenteve të dhëna nga këto ndërmarrje, konstatohet se nuk ndodhemi para kushteve të sipërcituara. Pra, në kuptim të Nenit 46 të Ligjit 9121, datë 28.09.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kërkesa e ndërmarrjeve “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në këtë nen.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të Nenit 24, germa (d) dhe Nenit 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjeve “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA për revokimin e Vendimit nr. 315, datë 13.05.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve”, si të pabazuar në ligj dhe prova.
2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 315, datë 13.05.2014 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve”.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij Vendimi ndërmarrjeve “KASTRATI” SHA dhe “KASPETROL” SHA.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCES**

**Servete GRUDA**

(\_\_\_\_\_)  
**Anetar**

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)  
**Anetar**

**Iva ZAJMI**

(\_\_\_\_\_)  
**Anetar**

**Rezana KONOMI**

(\_\_\_\_\_)  
**Zv/Kryetar**

**Lindita MILO(LATI)**

\_\_\_\_\_  
**KRYETAR**